



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 20

Prishtinë, më 07 maj 2018, në orën: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Ne mbledhje munguan: Fisnik Ismaili dhe Imet Rrahmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;**
3. **Shqyrtimi i propozimeve për tekstin e draftligjit për RTK-në;**
4. **Iniciativa e komisionit për plotësim -ndryshimin e ligjit për KPM-në dhe për hartim e draftligjit të mediave në Kosovë;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin si në vijim:

Pika e katër e rendit të ditës u shqyrtua para pikës së dytë, ndërsa pas pikës së tretë rendi i ditës u plotësua edhe me një pikë shtesë, si vijon: **Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve të**

përhershme parlamentare në raportin me rekomandime të komisionit funksional për P/ligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën;

2. Iniciativa e komisionit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për KPM-në dhe për hartim e draftligjit të mediave në Kosovë;

Për këtë pikë të rendit të ditës, nga të gjithë anëtarët e komisionit është nënshkruar nisma për plotësim ndryshimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe nisma për hartimin e draftligjit për mediat në Kosovë.

3 Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare;

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha propozimet dhe vërejtjet që janë adresuar në komision nga grupe të ndryshme të interesit si dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Gjithashtu, komisioni ka shqyrtuar edhe hulumtimin e KDI, lidhur me OJQ në rajon të cilin hulumtim KDI e ka realizuar sipas kërkesës së komisionit.

Pas shqyrtimit të të gjitha materialeve, komisioni ka vendosur që për hartimin e propozim amendamenteve në tekstin e draftligjit për OJQ-të merr për bazë ligjin e OJQ-ve të Gjermanisë.

Komisioni ka hartuar këto propozim - amendamente si vijon:

Propozim amendamenti 1

Neni 12, paragrafi 3, fshihen fjalët “dhe kompensimin të arsyeshëm”.

Propozim amendamenti 2

Neni 15, 16, 17 dhe 18 të riformulohen dhe të barten tek përkufizimet.

Propozim amendamenti 3

Neni 16, paragrafi 2, fshihet fjala “tre (3)”, zëvendësohet me fjalën “shtatë (7)”.

Propozim amendamenti 4

Neni 17, paragrafi 2, fshihet fjala “një”, zëvendësohet me fjalën “tre (3)”.

Propozim amendamenti 5

Neni 18, paragrafi 2, fshihet fjala “një”, zëvendësohet me fjalën “tre (3)”.

Propozim amendamenti 6

Neni 19, paragrafi 2, pas fjalëve “secili themelues” shtohen fjalët “dhe vërtetohet tek noteri”, teksti në vazhdim fshihet në tërësi.

Neni 19, bartet tek neni 15, kurse neni 15 bartet tek neni 19.

Propozim amendamenti 7

Neni 22, pas pikës së parë shtohet një pike e re me këtë formulim: **“OJQ regjistrohen përmes gjykatave komunale”**. ?????

Konstatim: Komisioni është dakorduar që për mbledhjen e radhës: të shqyrtohet propozimi për paragrafin 3 dhe 4 të nenit 29, të shqyrtohet propozimi për nenin 37, të qartësohet teksti i nenit 39 paragrafët 1 dhe 2, për nenin 41 të definohet se në cilin paragraf të vendoset formulimi “me vërtetimin e noterit” dhe të shqyrtohen propozimet e KCSF për paragrafin 6 të nenit 31.

4. Shqyrtimi i rekomandimeve të komisioneve të përhershme parlamentare në Raportin me rekomandime të Komisionit funksional për P/ligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/ Prishtinën;

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me datë 10.04.2018, ka dorëzuar Raportin me rekomandime për Projektligjin për kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, për shqyrtim në komisionet e përhershme parlamentare.

Pas shqyrtimit të raportit me rekomandime nga komisionet e përhershme-kryesore, Komisioni shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për propozim - amendamentet e komisionit funksional dhe nuk e ka përkrahur asnjë prej tyre.

Konstatim: Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të vazhdojë me shqyrtimin e Projektligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare për nenet në vijim.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani